



ANALIZË E POLITIKAVE

No. 1/16 – Janar 2016

**PANDËSHKUESHMËRIA NË KOSOVË:
LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT NDAJ
PROFILIT TË LARTË**

Ky Projekt mbështet nga Komisioni Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takojnë KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamjet e Komisionit Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përpiluar nga: Ariana Qosaj-Mustafa, Violeta Haxholli dhe Njomza Sejdullahu

Hulumtimi është i mbështetur nga: Vlora Gaxheri, Sihana Bina

E drejta autoriale © 2016 KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem ruajtës apo të transmetohet në ndonjë formë apo me anë të ndonjë mjeti, qoftë elektronik, mekanik, fotokopjim, incizues apo të tjera, pa lejen paraprake të publikuesit. Luteni të kontaktoni info@kipred.org apo +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Krëkime dhe Zhvillime të Politikave
Rruga Abdyl Frashëri, Nr.44
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 227 778
www.kipred.org



Syri i Vizionit
Rr. Isa Demaj, Nr. 14, 30000
Pejë, Kosovë
Tel. +381 (0) 39 423 240
www.syriivizionit.org

Përmbajtje

I.	Hyrje.....	1
II.	Kushtet e BE-së për Kosovën në luftën kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë.....	2
III.	Shumëllojshmëria e ligjeve, politikave dhe mekanizmave për të luftuar korrupsionin.....	4
IV.	Gjendja aktuale e punëve në luftën kundër korrupsionit: hetimi, ndjekja dhe dënimi i rasteve të korrupsionit	9
	a) Ndjekja e rasteve të profilit të lartë:.....	10
	b) Trajtimi dhe hetimi i rasteve të korrupsionit:.....	12
	c) Hetimet dhe aktakuzat ndaj rasteve të korrupsionit:.....	13
	d) Gjykimi i rasteve të korrupsionit nga gjykatat:.....	14
V.	Vonesat e qëllimshme në trajtimin e korrupsionit ndaj profilit të lartë: Parashkrimi i Rasteve të Korrupsionit.....	15
VI.	Hetimi dhe konfiskimi i pasurisë në rastet e korrupsioni të profilit të lartë.....	18
VII.	Përfundim dhe Rekomandime.....	22
VIII.	Shtojcë:	24

I. Hyrje

Pothuajse një dekadë nga shpallja e pavarësisë së saj, Kosova vazhdon të ketë vështirësi që të bëhet një shtet funksional. Pas zgjedhjeve të reja qeveritare të mbajtura në dhjetor 2014, Kosova përjetoi një gjendje të atillë ku një numër i madh i qytetarëve migruan ilegalisht në shtetet anëtare të BE-së. Raportet e EUROSTAT-it tregojnë që vetëm në muajt e parë të vitit 2015, afër 50000 persona nga Kosova kanë kërkuar azil në shtetet anëtare të BE-së, ndërsa ky numër ka rënë dukshëm në 10000 persona në çerekun e dytë të vitit 2015 (EUROSTAT komunikatë për shtyp 163/2015).

Më tej, polarizimi politik në mes të qeverisë aktuale të drejtuar nga PDK dhe LDK (Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës) dhe partitë opozitare (Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma) kanë penguar funksionalizmin e seancave të rregullta të Kuvendit të Kosovës qysh prej muajit shtator 2015. I bllokuar nga hedhja e gazit lotsjellës nga disa anëtarë të parlamentit të Kosovës, koalicioni në pushtet ka reaguar duke bërë arrestimin e këtyre anëtarëve të parlamentit apo duke i mbajtur seancat në vende të tjera brenda ndërtesës së Kuvendit, duke u pamundësuar anëtarëve të parlamentit nga radhët e opozitës që të marrin pjesë.

Përpjekjet e partive opozitare kundër koalicionit në pushtet kanë shpërthyer me përdorimin e mëtejshëm të mjeteve të rrezikshme dhe protestave të dhunshme në mënyrë që të përfundohet koalicioni ekzistues, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2014. Gjykata kishte vendosur që e drejta për të formuar qeverinë e re pas zgjedhjeve nacionale të mbajtura në vitin 2014 i është dhënë grupit parlamentar, i cili ka fituar numrin më të madh të votave.¹ Ky vendim i dha fund çdo lloj shprese për ndonjë koalicion post elektoral të formuar nga partitë politike jo-shumicë. Pas 6 muajsh të kësaj bllokade institucionale, LDK papritmas u shkëput nga koalicioni post elektoral i formuar bashkë me Nismën, VV-në, dhe AAK-në, duke formuar kështu bashkë me PDK-në qeverinë e re në dhjetor të vitit 2014. Zgjedhja e qeverisë nga PDK dhe LDK ishte një rezonim i koalicionit të ngjashëm të krijuar në Kosovës gjatë viteve 2007-2010. Më tej u shuan shpresat për qytetarët e Kosovës për çfarëdo lloj ndryshimi në mes të rritjes së vazhdueshme të pakënaqësive për shkak të mungesës së zhvillimit ekonomik dhe pretendimeve për një shkallë të lartë të korrupsionit.

Gjendja politike u acarua edhe më shumë me vazhdimin e protestave të dhunshme të organizuara nga partitë opozitare kundër marrëveshjeve të qeverisë së Kosovës me Serbinë në lidhje me të drejtën e Komunave me Shumicë Serbe për të formuar një Asociacion. Në një vendim të lëshuar në muajin dhjetor të vitit 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se Asociacioni nuk ishte “plotësisht në pajtim” me standardet e Kushtetutës së Kosovës për të drejtat e njeriut dhe parimet e diversitetit.² Vendimi nuk arriti që të zbut tensionet politike në mes të qeverisë dhe partive opozitare.

¹ Shiko vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KO119/04, i disponueshëm në: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_119_14_shq.pdf

² Shiko vendimin Gjykatës Kushtetuese Nr. KO130/15 i disponueshëm në: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_shq.pdf

Edhe për kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese, partitë opozitare kanë vazhduar që të përdornin gazin lotsjellës me qëllim të pengimit të punës së Kuvendit të Kosovës, duke insistuar në mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Madje, koalicioni në pushtet mbetet i vendosur që të qëndrojë në pushtet, duke u munduar që të menaxhojë paqen e brishtë me forcat e rënda policore.

Nën refrenin e përsëritur të “stabilitetit”, i cili është i mbështetur nga komuniteti ndërkombëtar dhe në mes të “jo-stabilitetit” të promovuar nga opozita e Kosovës, zhvillimet e Kosovës si një shtet funksional vazhdojnë të jenë të bishta. Në mesin e këtyre faktorëve politik, sistemi gjyqësor i Kosovës është larg nga përcimi i kërkesave të BE-së për t’i dhënë fund mosndëshkimit të korrupsionit ndaj profilit të lartë dhe nxjerrjes së rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar. Në dhjetor të vitit 2015, Kosova është vlerësuar se ka dështuar në zbatimin e 8 nga 95 kriteret e përcaktuara, në raportin e tretë dhe të fundit të Komisionit të BE-së për Kosovën. Të ngecur në harresë në mes të paqëndrueshmërisë politike dhe mungesës së vullnetit nga shtetet anëtare të BE-së për hequr politikisht regjimin për udhëtim të lirë pa viza për qytetarët e Kosovës, perspektiva e BE-së për Kosovën mbetet e mjegullt. Ndryshe, paqëndrueshmëria politike nuk ka qenë pengesë që BE-ja t’i lirojë qytetarët e Ukrainës dhe Gjeorgjisë nga udhëtimi i lirë në BE, që pritet të udhëtojnë të lirë gjatë vitit 2016.

Në klimën aktuale politike, korrupsioni në Kosovë është etiketuar në raportin e progresit të BE-së të 2015 si “endemic” dhe se përfundimi i korrupsionit të profilit të lartë duket të jetë larg realitetit. I karakterizuar me drejtësi selektive dhe emërime politike në bordet dhe ndërmarrjet publike, ai vazhdon të ketë ngecje në zbatimin e sundimit të ligjit dhe kushtet e përcaktuara nga BE-ja. Kosova vazhdon të ketë sfida në nxjerrjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të suksesshme në krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, autonom dhe mirë të baraspeshuar, në veçanti në rastet që ndërliken me korrupsionin në profilin e lartë.

II. Kushtet e BE-së për Kosovën në luftën kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë

Me gjithë plotësimin e shumicës së kushteve të përcaktuara nga BE-ja për Kosovën, lufta kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë dhe konfiskimi efektiv i pasurisë së pashpjegueshme mbetet akoma një kriter i pa përmbushur me prioritet të lartë.³ Një kusht ambicioz për një kohë të shkurtër, raporti lë anash verifikimin e pasurisë së zyrtarëve publik ashtu siç është kërkuar fillimisht me anë të marrëveshjes së Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave me arritur me Kosovën.⁴ Raporti gjithashtu kërkon transferimin e një numri të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në departamentin për krime të

³ Raporti i tretë i progresit i Kosovës në përmbushjen e kushteve të pacaktuara nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave (dhjetor 2015), i disponueshëm tek, http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/international-affairs/general/docs/third_report_progress_kosovo_fulfilling_requirements_visa_liberalisation_roadmap_en.pdf

⁴ Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave, i disponueshëm tek, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf

rënda nëpër tërë Kosovën si dhe ndërtimin e një regjistri të hetimeve, vendimeve të formës së prerë dhe konfiskimeve të kryera në rastet që ndërlidhen me krimet e rënda të organizuara dhe korrupsionit. Në veçanti raporti kërkon që Koordinatori Qendror për krime të rënda të organizuara dhe korrupsionit të jetë i pajisur me mandatin dhe burimet për të udhëhequr ekipe me disiplina të ndryshme të hetimeve financiare dhe gjithashtu të monitorojë ndjekjen gjyqësore të rasteve të tilla.⁵

Për më tepër, ashtu sikurse në raportet e mëparshme, Kosova vazhdon të demonstrojë rezultate të dobëta në luftën kundër korrupsionit, në veçanti në rastet që ndërlidhen me profilit të lartë. Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2015 konsideron se Kosova ndodhen në fazën fillestare në luftën kundër korrupsionit, në përgjithësi me një progres të kufizuar.⁶ Prandaj, vullneti i fuqishëm politik është i nevojshëm për të ndaluar këtë fenomen në mënyrë të duhur, i shoqëruar edhe me një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike që ofron rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Përveç kësaj, përparimi i vërtetë duhet të demonstrohet nga një histori e ndjekjes dhe dënimeve të suksesshme.⁷ Në mënyrë që të përmirësohet lufta e përgjithshme kundër korrupsionit, raporti i bën thirrje qeverisë së Kosovës për të kushtuar vëmendje të veçantë edhe prioritetit të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë, veçanërisht në sektorin e prokurimit publik, si dhe të sigurojnë dënime përfundimtare. Hetimet e korrupsionit të profilit të lartë janë të rralla dhe deri më tani nuk kanë rezultuar në dënime përfundimtare.⁸ Gjithashtu, bashkëpunimi në mes të policisë dhe prokurorisë duhet të forcohet me anë të hetimeve të përbashkëta në rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Sistemi i historisë të rasteve të trajtuara duke filluar nga hetimi deri në vendimin e formës së prerë duhet të plotësohet.⁹

BE-ja gjithashtu ka vënë në pah se ekziston një lidhje e ngushtë në mes të ndikimit të panevojshëm politik dhe kapacitetit të kufizuar për të kryer hetimet financiare në mënyrë efektive. Prandaj, konfiskimi efektiv i një aseti dhe kryerja e hetimeve financiare mbetet e kufizuar për shkak të mungesës së ekspertizës dhe gatishmërisë. Për më tepër, në mesin e rekomandimeve të dhëna ka qenë edhe integrimi i hetimeve financiare në të gjitha hetimet e korrupsionit dhe krimin të organizuar.¹⁰ Raporti gjithashtu rivendos ndikimin e vazhdueshëm dhe të tepruar politik mbi organet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.¹¹ Për këtë arsye, raporti u bën thirrje autoriteteve politike që të sigurojnë një fuqizim të organeve të zbatimit të ligjit në mënyrë që të sigurohet se ata do të veprojnë në mënyrë efektive dhe të paanshme në hetimin e korrupsionit.

BE-ja gjithashtu ka vënë në pah ekzistimin e vazhdueshëm të një numri të organeve të mandatuara për luftimin e korrupsionit, të cilat janë të shpërbëra dhe të shpërbëra, ndërsa në anën tjetër kanë mandate të cilat tejkalojnë përgjegjësitë e veta dhe ndarje të paqartë të detyrave. Raporti gjithashtu

⁵ Po aty,

⁶ Komisioni Evropian, 2015 Raporti i progresit për Kosovën, f.15. I disponueshëm tek, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

⁷ Po aty,

⁸ Po aty, f. 16.

⁹ Po aty, f. 15.

¹⁰ Po aty, f. 7.

¹¹ Po aty, f. 16.

vëren përfshirjen e shoqërisë civile në zhvillimin dhe monitorimin e politikave kundër korrupsionit, megjithëse me një proces këshillimi të cilit i mungonte transparenca dhe komunikimi konstruktiv.

Gjithashtu ekziston një nevojë për të korigjuar ligjin e aplikueshëm mbi konfliktin e interesit dhe ligjeve dhe rregulloreve të tjera të ngjashme, në atë mënyrë që të përputhen me standardet evropiane. Prandaj, duhet të ekzistojë nevoja e një përkufizimi të qartë për kategoritë e zyrtarëve publik, ndërsa në anën tjetër të adaptohen masat për parandalimin dhe sanksionimin e konfliktit të interesit.¹² Raporti e konsideron si një zhvillim pozitiv faktin se shumica e zyrtarëve të lartë kanë arritur që të bëjnë deklarin e pasurisë së tyre në vitin 2015 dhe Agjencia Kundër Korrupsionit ka ngritur 7 padi kundër zyrtarëve të lartë publik, të cilët nuk e kanë bërë deklarin e pasurisë së tyre. Megjithatë, Agjencia duhet që akoma më tepër të punojë në përcaktimin e pozitave me epërsi për të qenë të korruptuara dhe të marrë në konsideratë masat të cilat do të lejonin që të kryheshin hetime në mënyrë efektive kundër pasurisë së pashpjegueshme.¹³ Akoma mungon kapaciteti dhe vullneti i nevojshëm nga ana e prokurorëve për të ndjekur penalisht rastet kundër korrupsionit.¹⁴ Në mënyrë që të përmirësohet bashkëpunimi ndër-institucional ndërmjet prokurorëve dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit, miratimi i Procedurave Standarde Operative (PSO) në vitin 2014 për të përcaktuar përparësitë në rastet e krimeve të rënda në mes të agjencive është vlerësuar si një zhvillim pozitiv. Kjo rezultoi në përcaktimin me prioritet të 9 (nëntë) rasteve të ndërlidhura me korrupsionin e rëndë dhe të pastrimit të parave gjatë vitit 2015.¹⁵ Përsëri me rezultate të kufizuara, shumë sfida janë të përsëritura.

Shumica e kushteve të BE-se në lidhje me luftën kundër korrupsionit, janë të përsëritura nga Raportet e përparshme të Progresit. Deri më tani, elita politike e Kosovës ka demonstruar një vullnet marginal në adresimin serioz të kushteve të BE-së, në veçanti në dhënien fund të mosndëshkimit të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë. Si pasojë, mungesa e vullnetit politik ka çuar në rezultate të dobëta të institucioneve të sundimit të ligjit në luftimin e korrupsionit në mënyrë efektive. Përbushja e këtyre kërkesave është shumë e rëndësishme në mënyrë që Kosova të përparojë në rrugëtimin e saj për në BE. Për më tepër një gjë e tillë është edhe domosdoshmëri për zhvillimin e sistemit të drejtësisë në mënyrë të pavarur, autonome dhe të ekuilibruar, ashtu që të ndërtohet një shtet funksional dhe i qëndrueshëm për qytetarët e saj.

III. Shumëllojshmëria e ligjeve, politikave dhe mekanizmave për të luftuar korrupsionin

Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të dënimeve të formës së prerë në luftën kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë, edhe pse vazhdimisht ajo ka ndryshuar ligjet dhe ka krijuar mekanizma të reja. BE-ja ka vlerësuar se në përgjithësi legjislacioni është në përputhshmëri me

¹² Po aty,

¹³ Po aty,

¹⁴ Po aty, f. 16 dhe 17.

¹⁵ Po aty.

acquis-në e BE-së, megjithatë hartimi i disa ligjeve, akteve nënligjore dhe mekanizmave është vlerësuar si një taktikë e vazhdueshme e Qeverisë së Kosovës (QK) për të përhapur burimet dhe për të zvogëluar rëndësinë e atyre ekzistuese.¹⁶ Karakterizuar me reagime *ad hoc* dhe me mbivendosje mandatesh, mekanizmave dhe ligjeve të miratuara, shpesh u ka munguar një analizë dhe qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike. Reagimi është ndikuar shpesh nga politika në mënyrë që të çohen përpara proceset politike lidhur me BE-në, siç janë kërkesat për liberalizimin e vizave.

Që nga viti 2004, Kosova ka hartuar një sërë ligjesh për luftimin e korrupsionit duke filluar nga Ligji kundër Korrupsionit,¹⁷ dhe duke përfunduar me ndryshimet e fundit në Kodin Penal të Kosovës (2013), me një kapitull specifik i cili trajton 16 vepra penale në lidhje me korrupsionin zyrtar dhe kryerjen e detyrave zyrtare.¹⁸ Si risi në kodin penal paraqitet edhe konflikti i interesit (Neni 430), dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj (neni 430) dhe mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (neni 437). Duke reaguar ndaj fenomenit sistematik të korrupsionit si dhe kushteve të BE-së, Qeveria e Kosovës ka shtytur miratimin edhe të disa ligje të tjera specifike siç janë: Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për deklarimin e pasurisë)¹⁹ dhe Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale.²⁰

Duke pasur një numër të madh të shkeljeve penale, Kodi Penal i ri në krahasim me Kodin e UNMIK-ut të vitit 2003, ka paraparë dënime më të lehta për sa i përket abuzimit me detyrën zyrtare, duke e ulur dënimin me burgim nga tetë (8) në pesë (5) vite.

Ndryshe, vendet e tjera të rajonit si Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia, i kanë rritur dënimet në lidhje me abuzimin e detyrës zyrtare, duke filluar nga pesë (5) në dhjetë (10) vite, varësisht nga madhësia e keqpërdorimit nga personi zyrtar.²¹ Për një vend që karakterizohet me korrupsion të gjerë, një ulje e tillë e dënimet nuk është e justifikueshme. Megjithatë, Kodi ka përcaktuar në mënyrë

¹⁶ Shih për shembull raportin e KIPRED-it “Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e Pajustificueshme: nëntor, 2013, i disponueshëm tek,

http://www.kipred.org/repository/docs/THE_IMPUNITY_IN_KOSOVO_INEXPLICABLE_WEALTH_632453.pdf.

¹⁷ No.2004/34, Ligji kundër Korrupsionit, i disponueshëm tek,

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_34_en.pdf

¹⁸ Shih Kodi Penal tek: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>.

¹⁹ Ligji Nr. 04/L-050, Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, i disponueshëm tek,

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20declaration%20of%20property%20of%20senior%20public%20officials.pdf>

²⁰ Ligji Nr. 04/L-140, Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale, i disponueshëm tek,

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20extended%20powers%20for%20confiscation%20of%20assets%20acquired%20by%20criminal%20offence.pdf>

²¹ Shih për shembull Kodin Penal të Maqedonisë, neni 353, Kodin Penal të Serbisë, neni 359, Kodin Penal të Kroacisë, neni 317, dhe Kodin Penal të Malit të Zi, neni 416.

të detajuar se çfarë përfshinë shpërdorimi i pozitës zyrtare,²² një aspekt ligjor i cili mungonte në Kodin e mëparshëm.

Ndryshe, për shkeljet e dhënies dhe pranimit të ryshfetit, krahasuar me kodin e përparshëm, dënimet janë rritur deri në tetë (8) vite, nëse veprat e tilla tejkalojnë përfitimin në shumë prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) eurove.²³ Megjithatë, efekti afatgjatë i luftimit të veprave penale të korrupsionit dhe dhënies së ryshfetit, mund të ketë një qëllim parandalues, megjithatë mbetet të analizohet më tej se deri në çfarë mase kjo dispozitë e ka ulur raportimin e korrupsionit në agjencitë për zbatimin e ligjit nga qytetarët që mund të kenë qenë të përfshirë në çështjet e lidhura me korrupsion.

Për më tepër, Kuvendi i Kosovës ka hartuar një ligj shtesë për pos dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë ilegale, dhe aq më tepër e ka adaptuar edhe një ligj special, i cili është Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Ligji parasheh kompetenca të zgjeruara për procedurat e parapara në Kodin e Procedurës Penale, kur këto dispozita nuk janë të mjaftueshme. Në muajin mars të vitit 2015, një grup punues parlamentar filloi të bëjë monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe duke sjellë gjithashtu edhe ndikimin e shoqërisë civile. Edhe pse ky ishte një hap pozitiv, grupi punues është takuar vetëm një herë për në një periudhë gati shtatë mujore për shkak të bllokimit të Kuvendit nga ana e opozitës. Monitorimi i ligjit nga ana e KIPRED-it ka treguar disa mangësi për shkak të niveli të ulët të zbatimit. Ligji deri më tani është kategorizuar të jetë përdorur vetëm një herë dhe pothuajse ka mbetur i panjohur në zbatim nga ana e prokurorisë dhe gjyqësorit që nga miratimi i tij.²⁵

Përveç kësaj, dispozitat e tjera ligjore parashohin gjithashtu se zyrtarët e lartë publik janë të detyruar që të bëjnë deklarinë e pasurisë dhe të hyrave të tyre si dhe origjinën e tyre pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) në pajtueshmëri me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë.²⁶ Megjithatë, verifikimi i pasurisë është treguar të jetë i vështirë pasi që prokurorët pretendojnë se ata nuk kanë bazë të mjaftueshme ligjore për të ndërmarrë hapa në iniciimin e hetimeve.²⁷ Megjithatë, në mënyrë që të kryhet verifikimi, prokurorët mund të mbështeten në ndonjë dyshim të arsyeshëm që pasuria është fituar me vepër penale. Deri më tani, zyrtarët e lartë janë verifikuar vetëm nga ana e AKK-së me një kapacitet për të verifikuar vetëm 20% të zyrtarëve. BE ka rekomanduar që agjencia nuk duhet të përziejdh zyrtarët e lartë për verifikim vetëm rastësisht, por edhe duhet të përziejdh personat në

²² Shih nenin 422, paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës, "... Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në: 2.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit; 2.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose 2.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegj, pushteti apo imuniteti ligjor...", i disponueshëm tek <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>.

²³ Neni 429, paragrafi 3 i Kodit Penal.

²⁴ Po aty, Neni 428, paragrafi 3.

²⁵ Po aty,

²⁶ Ligji për deklarinë e pasurisë, neni 5.

²⁷ Intervistë e KIPRED me Prokurorët e Shtetit, shtator 2015, Prishtinë

pozita të cilat mund të kenë më shumë prirje për t'u korruptuar.²⁸ Për më tepër, dështimi për të mos raportuar apo për të raportuar rrejshëm pasurinë dhe përfitimet materiale ose detyrimeve të tjera financiare, është i penalizuar sipas nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës, i cili është i dënueshëm me burgim deri në tre (3) vjet, dhe nëse të dhënat janë falsifikuar deri në pesë (5) vjet burgim. Masat e fundit ndëshkuese kanë arritur vetëm qëllimin e kundërt, duke shkaktuar rënie të gjobave dhe dënimeve në krahasim me atë kur shkelja është përcaktuar si kundërvatje.²⁹ Efektet e ligjit kanë qenë negative, dhe të kundërta me pritjet, të cilat kanë pasur qëllim për të forcuar raportimin e saktë të zyrtarëve të lartë.

Deri në fund të vitit 2013, Kosova nuk arriti që të përkufizojë qartë se çfarë konsiderohet korrupsion i profilit të lartë. Me lëshimin e një Udhëzimi Administrativ (UA) (2013), Kryeprokurori i Kosovës, Kryeprokurori i EULEX-it dhe Kryeprokurori i PSRK, përcakton pozitën dhe vlerën monetare të veprave të korrupsionit të cilat konsiderohen si korrupsion i profilit të lartë.³⁰ Sipas UA-së, veprë penale e korrupsionit, të cilën prokurorët duhet ta hetojnë, janë ato raste kur subjekti i dyshuar për kryerjen e kësaj veprë është ekzekutivi qendror dhe drejtuesit e komunave, si Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe kabineti ministror, kryetarët e komunave dhe shërbyesit civil të menaxhimit të lartë, siç janë Sekretari i Përgjithshëm dhe punonjësit në pozita vendimmarrëse, siç është Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit. Një veprë penale e korrupsionit të lartë konsiderohet ajo shkelje që mund të ketë shkaktuar një dëm në vlerë monetare prej 500,000.00 Eurove e më lartë.³¹ Në rastet kur dëmi konsiderohet të jetë më i lartë se 1 milion euro, automatikisht ai rast përkufizohet si një rast i korrupsionit të lartë.³² Edhe pse ekziston përkufizimi i qartë ligjor, i siguar nga shërbimet e prokurorisë, zbatimi i saj, në veçanti në nivelin e PSRK-së, ka qenë i dobët siç tregohet nga analiza e mëtejme.

Në fushën e hartimit dhe zhvillimi të legjislacionit të ri, në vitin 2015 Qeveria Kosovës inicioi hartimin e të ashtuquajturit "Ligji Kundër Mafies", i cili ka për qëllim të bëjë bartjen e barrës së provave nga prokurorët, të cilët hetojnë rastin, tek zyrtari i dyshuar për pasuri të pashpjegueshme. Duke u parë si një iniciativë me potencial për të shkelur të drejtat e njeriut, me fjalët të tjera me potencial për privimin e të drejtës së pronës, të garantuar me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Qeveria në Koncept Dokumentin e saj kishte vënë re këtë

²⁸ Faqe 17 e Raportit të Progresit për Kosovën të BE-së, 2015, i disponueshëm tek

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

²⁹ Intervistë e KIPRED me zyrtarin e lartë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, gusht 2015.

³⁰ Veprat Penale lidhur me korrupsionin janë marrë nga Kodi Penal, si vijon: 1. Lidhja e kontratave të dëmshme, rënduar nga ryshfeti (neni 291(2)), Dhënia e paarsyeshme e dhuratave (316), Arratisja e personave të privuar nga liria, rënduar nga ryshfeti (405 (2)), Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria (406(2)), Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (422), Përvetësimi në detyrë (425), Mashtrimi në detyrë (426), Përdorimi i paautorizuar i pasurisë (427), Marrja e ryshfetit (428), Dhënia e ryshfetit (429), Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj (430), Ushtrimi i ndikimit (431), Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (432), Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (435), Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (436) Shih http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezim_kur_nje_veper_e_korrupsionit_do_te_konsiderohet_si_e_nivelit_te_larte.pdf

³¹ Po aty,

³² Po aty, neni 1.

rrezik.³³ Bartja e barrës së provave shihet gjithashtu si kundërthënëse ndaj parimit të “supozimit të pafajësisë”, si parim themelor në të drejtën procedurale penale.³⁴ Megjithatë, Kosova duhet të marrë në konsideratë konfiskimin të pasurisë të sojit të njëjtë (*in rem*) të përfutur me vepër penale, me një barasvlerë të probabilitetit bazuar në standardet e të drejtës civile dhe jo në standardet e të drejtës penale përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.³⁵ Masa të tilla të përkohshme duhet të krijojnë një bazë të mjaftueshme ligjore për të hetuar pasurinë e pashpjegueshme.

Në mesin e shumë ligjeve dhe akteve nënligjore, Kosova ka krijuar edhe një numër të mekanizmave institucionale në përpjekjet e saj për luftimin e korrupsionit. Një trashëgimi e ligjeve nga periudha e UNMIK-ut³⁶ dhe pjesë e pakos së Ahtisarit, është edhe themelimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (ZPSRK). Megjithatë, kjo zyrë nuk ka arritur që të nxjerrë numrin e kërkuar të lëndëve të hetuara dhe të përfunduara. Për shembull, deri në tetor të vitit 2015, mesatarisht një prokuror i ZPSRK-së ka trajtuar 13.6 për qind të lëndëve në nivel vjetor,³⁷ nëse krahasohet me 2 (dy) lëndë në muaj apo 22 lëndë në vit, siç kërkohet me normat orientuese të Këshillit Prokurorial të Kosovës.³⁸ Me një buxhet vjetor prej jo më shumë se 899,085.00 euro për prokurorët special, ZPSRK nuk është pajisur me burime të mjaftueshme si një organ i veçantë që është, gjë që ka çuar në rezultate të dobëta në luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë. Paralelisht me këtë, Qeveria e Kosovës ka vazhduar të shtyjë në mënyrë paralele krijimin e një sërë mekanizmash për të luftuar korrupsionin duke e minuar potencialin dhe autonominë e ZPSRK-së. Për shembull, në shkurt të vitit 2010, Kryeministri i Kosovës ka nxjerrë një vendim për të formuar një Task Forcë të përbërë nga policia dhe prokuroria në luftën kundër korrupsionit, si pjesë e PSRK-së.³⁹ Për më tepër, kohët e fundit, Kryeprokurori i ri i Shtetit në përputhje me kërkesat e BE-së për liberalizimin e vizave ka emëruar një ekip të specializuar për të hetuar krimet financiare dhe ekonomike, nën udhëheqjen e Koordinatorit Kombëtar për rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, i cili vepron ndaras nga struktura e ZPSRK, duke rezonuar kështu një “mini-ZPSRK”. Mbetet e paqartë nëse

³³ Kthimi i barrës së provës në konfiskimin e të hyrave me vepër penale: Një studim i praktikave më të mira të Këshillit të Evropës, “*Best Practice Survey*” Nr. 2, faqe. 7, i disponueshëm tek

http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/moneyval/web_ressources/CoE_BP_burdenproof.pdf

³⁴ Raporti i Progresit për Kosovën 2015, f. 16.

³⁵ KIPRED Raporti, “Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e Pashpjegueshme”, Nëntor 2013, f.16. I disponueshëm tek

http://www.kipred.org/repository/docs/THE_IMPUNITY_IN_KOSOVO_INEXPLICABLE_WEALTH_632453.pdf

³⁶ I adoptuar në mars 2008, i disponueshëm tek <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/03-L-052%20a.pdf>

³⁷ Shih f. 25, tek: <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2015/12/2.-Fighting-Corruption-in-Kosovo-Priority-in-letter1.pdf>

³⁸ F. 18, neni 2 pika 1.5 i Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e normës orientuese vjetore për prokurorët, aprovuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, janar 24, 2012. Shiko vegëzën 2012, [per_Percaktimin_e_Normes_Orientuese_Vetore_per_Prokurore.pdf](#)

³⁹ Shiko Raportin e KIPRED-it për Përmbyshjen e Kushteve të BE-se në Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, 2014. I disponueshëm tek

http://www.kipred.org/repository/docs/KIPRED_SiV_Brief_Fulfilling_the_EU_Requirements_in_Anti_Corruption_and_Organized_Crime_833217.pdf

mandati i ZPSRK-së do të dublifkohet dhe do të përkojë me rolin e ZPSRK-së pasi që mandati me rastet ndaj profilit të lartë mbetet në atë zyrë.

Liria e autoriteteve të sundimit të ligjit është minuar në vazhdimësi si rezultat i lidhjeve në mes të autoriteteve politike dhe autoriteteve gjyqësore. Për më tepër, mungesa e mekanizmave të duhur të kontrollimit të autoriteteve gjyqësore ka rezultuar në mungesë të llogaridhënies së këtyre autoriteteve, gjë të ka prodhuar edhe në rezultate të dobëta në luftën kundër korrupsionit. Për më tepër misioni për sundimin e ligjit i BE-së, EULEX, si misioni më i madh i huaj dhe për çështje të sigurisë, me një buxhet të harxhuar me mbi 950.00 milion euro, prej vitit 2009, ka mandat për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë.⁴⁰ Megjithatë, misioni, mes tjerash, është preokupuar edhe me akuzat e personelit të tyre për korrupsion, që kanë shpërthyer në vitin 2014 me rastin e Maria Bamieh, një ish-prokurore e BE-së nga Britania, e cila ka ngritur dyshime mbi korrupsionin e brendshëm të stafit të lartë të EULEX-it. Pretendimet penale të rastit janë në procedurë/ vazhdim e sipër me Bamieh, e cila pretendon se misioni ka tentuar ta heshtë atë si “informante/ sinjalizuese”, dhe ka vendosur që pretendimet e saj në lidhje me diskriminimin t’i bëjë objekt shqyrtimi pranë një gjykate për çështje të punësimit në Londër. Dyshimet nuk janë konfirmuar akoma. Si do që të jetë, faktet tregojnë se edhe pse kanë kaluar shtatë vjet nga përfshirja e këtij misioni, korrupsioni vazhdon të jetë i lartë në Kosovë, ndërsa misioni është karakterizuar pjesërisht me qeverisje “jofunksionale” dhe larg nga fillimi i hetimeve të pavarura dhe autonome. Në veçanti, Kosova me mbështetjen e EULEX-it është vlerësuar se ka dështuar në krijimin e themeleve për një sistem i cili do të mund të luftonte në mënyrë efektive korrupsionin.⁴¹

Në fund, në Kosovë janë hartuar disa ligje dhe akte nënligjore për të trajtuar aktet e korrupsionit. Pavarësia e autoriteteve të sundimit të ligjit është minuar në mënyrë të vazhdueshme si rezultat i iniciativave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës, të cilat shpesh janë dominuar nga një reaksion i dobët i autoriteteve të gjyqësorit. Një rishikim i plotë dhe strategjik i reagimit të sistemit gjyqësor në rastet e korrupsionit është i nevojshëm, në mënyrë që të ikim nga reagimet *ad hoc* shpesh të dominuara nga proceset politike.

IV. Gjendja aktuale e punëve në luftën kundër korrupsionit: hetimi, ndjekja dhe dënimi i rasteve të korrupsionit

Përpjekjet e institucioneve shtetërore për të luftuar këtë problem kanë prodhuar rezultate të turpshme për shkak të mungesës së vullnetit politik për të ndërtuar sistem gjyqësor të pavarur dhe me kapacitete të mjaftueshme, ndjekur nga performanca e dobët e institucioneve të sundimit të ligjit.

⁴⁰ Shih <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,16>.

⁴¹ Shih fq.22 të “Review of the EULEX Kosovo Mission’s Implementation of the Mandate with a Particular Focus on Handling of the recent allegations,” Report to the Attention of the High Representative/Vice President of the European Commission, Ms Federica Mogherini. Përgatitur nga Prof. Jean-Paul Jacque, sipas kërkesës së EEAS, Drejtori i Përgjithshëm i Nderit i Këshillit të BE-së, 31 mars 2015.

Për shembull, sektori i prokurimit publik mbetet një ndër sektorët me prirjen më të madhe për korrupsion të nivelit të lartë.⁴² Ndër vite tanimë edhe BE-ja ka arritur që ta pranojë këtë fushë si një fushë me potencial të lartë për zhvillimin e korrupsionit.⁴³ Si i tillë ky sektor konsumon një sasi të lartë të parasë publike, me 488 milion euro të shpenzuar gjatë vitit 2014 me anë të përdorimit të procedurave të prokurimit publik dhe me një shpenzim të përafërt vjetor prej 30% të Buxhetit të Kosovës.⁴⁴ E ashtuquajtura “tender-mania” ka siguruar që bizneset e afërta me zyrtarët e lartë në pushtet të fitojnë tenderë në shkëmbim të financimit të partive politike të caktuara. Shpeshherë disa operatorë ekonomik sigurojnë ekzistencën e tyre kryesore vetëm prej punës dhe shërbimeve ndaj autoriteteve publike.⁴⁵ Që prokurimi publik të vazhdojë të jetë një ndër sektorët me prirjen më të madhe për korrupsion është mundësuar nga ndryshimet e shpeshta të Ligjit të Prokurimit Publik gjatë viteve të fundit, duke shkaktuar pengesa të qëllimshme në implementimin e ligjit. Për më tepër, emërimi me takt në funksionalizimin e Autoritetit për Shqyrtimin e Prokurimit është vonuar nga ana e partive politike në pushtet në mënyrë që të dobësohet procesi i monitorimit të prokurimit në Kosovë.⁴⁶ Shpesh ndryshimet ligjore të sponsorizuara nga qeveria, janë përdorur me takt për të siguruar një mburojë ndaj hetimeve kundër korrupsionit dhe shpesh duke pasur mandate të njëjta kanë vazhduar të krijojnë një sërë mekanizmash për të luftuar korrupsionin.

a) Ndjekja e rasteve të profilit të lartë:

Edhe përkundër zotimit publik për luftimin e korrupsionit, partnerët në sundimin e ligjit kanë vazhduar që të merren kryesisht me krime të vogla të korrupsionit, ndërsa hetimet e rasteve të profilit të lartë të rasteve të korrupsionit kanë mbetur të vogla.⁴⁷ Shërbimet prokuroriale kanë pranuar se shpesh puna e prokurorëve të shtetit dhe gjyqtarëve nuk shkon përtej thirrjes publike për të luftuar korrupsionin.⁴⁸ Mungesa e rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë është i ndërlidhur gjithashtu edhe me ndërhyrjet politike dhe neglizhencën e prokurorëve, e që shpesh përcillet edhe me presionin e mediave.⁴⁹ Së fundi, prokurori i PSRK dhe ish Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, ka lëshuar një deklaratë shqetësuese në lidhje me punën e shërbimeve prokuroriale duke e përsëritur se prokurorët shpesh i kryejnë hetimet nga zyrat, duke qëndruar të ulur në kafene dhe restorante me politikanët, të cilët kanë një sjellje burokratike. Në

⁴² Intervistë e KIPRED me prokurorë dhe gjyqtarë, gusht 2015 në Prishtinë.

⁴³ Shiko Raportet e Progresit për Kosovën 2013, 2014 dhe 2015.

⁴⁴ Republika e Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti Vjetor i Auditimit 2014, f.39. Në: http://oag-rks.org/repository/docs/RVA-Eng_319961.pdf

⁴⁵ Këshilli i Evropës, Projekti Kundër Krimeve Ekonomike (PKKE), Raporti i Vlerësimit për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit, prill 2015, f. 104. At, http://www.psh-ks.net/repository/docs/AC_ENG_WEB.pdf

⁴⁶ Po aty, f. 104.

⁴⁷ Intervistë e KIPRED me gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, 21 gusht 2015.

⁴⁸ Intervistë e KIPRED me Prokurorin Special të PSRK në Prishtinë, shtator 2015 në Prishtinë.

⁴⁹ " Jemi të mërzitur, jemi të lodhur nga prokurorët burokratë, të cilët i zhvillojnë hetimet nga zyrat e tyre apo nga kafenetë apo restorantet duke drekuar me politikanë në disa raste edhe me persona të dyshimtë. Jemi të lodhur nga prokurorët, të cilët më shumë kujdesen për interesat e tyre personale, për privilegjet e tyre, sesa për luftën kundër kriminalitetit. Kjo është edhe për ne e papranueshme", Shikoni deklaratën e prokurores Drita Hajdari në portalin e lajmeve TELEGRAFI, “Pak kush po e lufton korrupsionin”, 15 shtator 2015. Përkthim i KIPRED-it marrë nga: <http://www.telegrafi.com/ekonomi/lajme-ekonomi/pak-kush-po-e-lufton-korrupsionin.html>.

raste të tjera, presioni ndaj prokurorëve është i drejtpërdrejtë ose shfaqet nëpërmjet fushatave nëpër mediae.⁵⁰ Fazat fillestare të hetimeve shpesh rrjedhin si informacion nëpërmjet artikujve të botuar në mediat publike, duke rritur në këtë mënyrë presionin publik ndaj prokurorëve të caktuar. Për këtë arsye, prokurorët shpesh me vetëdije vendosin që të mos merren me raste të mëdha në mënyrë që t'i shmangen ekspozimit në media.⁵¹

Për më tepër, në nëntor të vitit 2013 me qëllim të trajtimit të rasteve të korrupsionit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) kishte adaptuar një Plan Veprimi duke mbuluar rastet e korrupsionit deri në fund të muajit qershor 2014.⁵² Përkundër këtij plani të veprimit, rezultatet ishin minimale. Për shembull, në kornizën kohore të përcaktuar nga plani i veprimit, PSRK ka pasur 55 raste të korrupsionit kundër 322 personave.⁵³ PSRK ka arritur të kryej vetëm 18 raste kundër 121 personave apo 33% të rasteve në procedurë. PSRK ka vazhduar të neglizhojë normën e caktuar të punës, në veçanti në shfrytëzimin e ekspertëve potencial për të kryer hetimet në krimet ekonomike dhe krimet financiare. Edhe pse ekzistojnë ekspertë të profilizuar, duke përfshirë nëntë (9) ekspertët financiarë që mbulojnë prokurimin, taksat dhe çështje të tjera financiare, ndihma e tyre është përdorur rrallë nga ana e prokurorëve special.⁵⁴

Përveç kësaj, prokurorët ankohen për vështirësi në të provuarit e rasteve të tyre para gjykatës për shkak të kompleksitetit të rasteve të profilit të lartë, shpesh të karakterizuara me refuzimin e dëshmitarëve për të bashkëpunuar dhe pengesave të rastit nga ana e institucioneve të ndryshme për t'iu përgjigjur në kohë ndaj kërkesave të tyre.⁵⁵ Gjithashtu mungesa e një departamenti të veçantë që të merret me rastet e paraqitura nga ana e PSRK brenda gjykatave shkakton vonesa në procedimin e rasteve nga Gjykata Themelore në Prishtinë.⁵⁶ Në përgjithësi, shumicës së prokurorëve dhe gjyqtarëve u mungon ekspertiza në trajtimin lëndëve komplekse që kanë të bëjnë me korrupsionin, të cilat shpeshherë janë të ndërlidhura me krime komplekse financiare, dhe për këtë arsye ata vazhdojnë të kenë performancë të dobët në veçanti në trajtimin e rasteve të korrupsionit, në mënyrë specifike të atyre të profilit të lartë.

Prandaj, mbështetja ndaj gjykatave duhet të fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve të strukturave gjyqësore, duke u përqendruar në nevojën që shërbimet prokuroriale të ndërhyjnë në mënyrë që prokurorët të nxirren nga zonat e tyre të rehatisë dhe të merren me rastet e korrupsionit.

⁵⁰ Intervistë e KIPRED me Prokurorin Special të PSRK në Prishtinë, 22 shtator 2015 në Prishtinë

⁵¹ Po aty.

⁵² Këshilli Prokurorial i Kosovës, Plan i veprimit rritjen dhe efikasitetin e sistemit prokurorial në luftën kundër korrupsionit, f. 3. Vegëza: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Action_Plan_-_Corruption.pdf

⁵³ Raport i Prokurorit të Shtetit, f. 3, e qasshme në http://www.psh-ks.net/repository/docs/284_Raport_mbi_zbatimimin_e_planit_te_veprimit.pdf

⁵⁴ Deklarata e zyrtarit të lartë të Zyrës së BE-s në Kosovë, në Tryezën e Rrumbullakët të organizuar nga KIPRED SiV, tetor 2015 në Prishtinë.

⁵⁵ Intervistë e KIPRED me Prokurorin e Shtetit, Prishtinë, 23 shtator 2015 në Prishtinë

⁵⁶ Intervistë e KIPRED me Prokurorë të shtetit dhe gjyqtarë, gusht, shtator 2015, Prishtinë

Ata shpesh duket se rrijnë rehat duke mos trajtuar rastet e korrupsionit të profilit të lartë në mënyrë që të mos i ekspozohen presionit të mediave.

b) Trajtimi dhe hetimi i rasteve të korrupsionit:

Prej vitit 2013 deri në gjysmën e parë të vitit 2015, hetimi dhe paraqitja e rasteve të korrupsionit nëpërmjet raporteve penale, janë iniciuar kryesisht nga Policia e Kosovës, të shoqëruara nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Vetë-iniciativa e prokurorëve për të hetuar dhe përcjellë kallëzimet penale të rasteve të korrupsionit ka vazhduar të jetë minimale gjatë periudhës së monitoruar. Për shembull, gjatë vitit 2013 prokurorët kanë paraqitur vetëm 4 (katër) raporte për korrupsion me vetë-iniciativë. Në vitin 2014 rastet me vetë-iniciativë nga ana e prokurorëve ka pësuar një rritje të vogël, në 11 raste të korrupsionit, ndërsa në gjysmën e parë të vitit 2015 vetë-iniciativa ka rënë në zero raste të raportuara nga prokurorët (Shih Tabelën 1.1 në Shtojcë). Në mënyrë të veçantë, është me interes të veçantë mungesa e iniciativave nga ana e prokurorëve të PSRK, të cilët kanë mandat për t'u marrë me rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Nga viti 2013 deri në gjysmën e parë të vitit 2015, nuk ka pasur raste të paraqitura të raporteve penale në rastet e korrupsionit të iniciuara nga prokurorët special (Shih Tabelën 1.2).

Gjatë vitit 2013 kanë ekzistuar 778 raste të korrupsionit në pritje për t'u zgjidhur nga ana e prokurorëve. Në fund të vitit 2013 janë zgjidhur vetëm 40% të rasteve nga ana e prokurorëve apo 314 raste. Në fund të vitit 2013 shumica e rasteve të ndërlidhura me korrupsionin kanë mbetur të pazgjidhura, ose me fjalë të tjera 464 raste apo 60% e tyre (Shih Tabelën 1.3). PSRK me mandat për të trajtuar rastet e korrupsionit të profilit të lartë, ka punuar gjithsej me 47 raste gjatë vitit 2013. Në fund të vitit 2013 PSRK ka arritur të zgjidh vetëm 17 raste apo 36% të tyre. Shumica e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë kanë mbetur të pazgjidhura, respektivisht 30 raste apo 64% e tyre (Shiko Tabelën 1.4).

Të dhënat e dobëta e prokurorisë në hetimin e rasteve të korrupsionit ka vazhduar edhe në vitin 2014 si dhe në pjesën e parë të vitit 2015. Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2014 tregon përmirësime të vogla me 444 lëndë të zgjidhura për çështje që lidhen me korrupsionin prej 976 lëndëve në pritje për t'u zgjidhur apo 45% e tyre. Në fund të vitit 2014 kanë qenë 532 lëndë të pazgjidhura për çështje që lidhen me korrupsionin apo 55% e tyre (Shih Tabelën 1.3). Ndryshe, gjatë vitit 2014 rezultatet e vetëm prokurorëve të PSRK-së kanë qenë më pak të kënaqshme me vetëm 17 lëndë të zgjidhura për çështje që lidhen me korrupsionin prej 66 lëndëve në pritje për t'u zgjidhur apo 26% e tyre. Në fund të vitit 2014 numri i përgjithshëm i lëndëve të pazgjidhura nga ana e PSRK-së ka arritur në 74% (Shih Tabelën 1.4).

Gjysma e parë e vitit 2015 ka shënuar sërish një mungesë të trajtimit të kënaqshëm të rasteve të korrupsionit në përgjithësi. Nga 717 lëndëve në pritje për t'u zgjidhur dhe të bartura nga vitet e mëparshme, janë vetëm 128 lëndë të zgjidhura në lidhje me korrupsionin apo 18% e tyre (Shih Tabelën 1.3). Më tej, vetëm PSRK-ja ka arritur të zgjidh vetëm 5 (pesë) raste të për çështje që lidhen me korrupsionin prej 53 lëndëve në pritje për t'u zgjidhur apo 9% e tyre (Shih Tabelën 1.4).

c) Hetimet dhe aktakuzat ndaj rasteve të korrupsionit:

Në vitet e fundit ka pasur një rritje në raportimin e përdorimit të masave të fshehta nga ana e prokurorëve në hetimin e rasteve të korrupsionit. Përdorimi i masave të fshehta është rritur në masë të madhe përgjatë viteve, me një raportim të 96 urdhrave të dhënë për përdorimin e masave të fshehta gjatë vitit 2013, 118 masa të fshehta të përdorura gjatë vitit 2014 dhe 123 urdhra të dhënë gjatë gjysmës së parë të vitit 2015.⁵⁷

Megjithatë, prej totalit të lëndëve të parashtruara me kallëzime penale për korrupsion, prokurorët kanë vazhduar trendin e refuzimit apo ndërprerjen e hetimeve për një numër të madh të personave, duke akuzuar vetëm disa raste. Në vitin 2013, prej 665 personave me kallëzime penale për korrupsion, prokurorët kanë hedhur poshtë/mbyllur apo ndërprerë hetimet për 353 persona apo për 53% të lëndëve. Vetëm 47% të lëndëve janë akuzuar për korrupsion të parashtruara kundër 312 personave. Ky trend ka vazhduar edhe gjatë vitit 2014. Me kallëzime penale kundër 1011 personave, prokurorët kanë hedhur poshtë/mbyllur apo ndërprerë hetimet për 545 persona apo për 54% të lëndëve. Gjatë vitit 2014 prokurorët kanë akuzuar 471 persona apo 47% të tyre. Në gjysmën e parë të vitit 2015, prokurorët kanë shënuar një rënie të ulët të aktakuzave kundër 185 personave apo 61% të lëndëve, dhe kanë hedhur poshtë/mbyllur apo ndërprerë hetimet kundër 116 personave apo 39% e tyre (Shih Tabelën 1.5).

Për më tepër, gjatë gjithë periudhës raportuese PSRK ka treguar rezultate të dobëta në aktakuza. Numri i personave ndaj të cilëve kallëzimet penale janë hedhur poshtë/mbyllur ose ndërprerë ka qenë i lartë gjatë viteve 2013 dhe 2014. Vetëm në vitin 2013, ndaj 98 personave me kallëzime të ngritura penale, prokurorët special të PSRK kanë hedhur poshtë/mbyllur kallëzime penale dhe kanë mbyllur hetimet për 69 persona apo 70% të rasteve. Vetëm 29 persona janë akuzuar për korrupsion apo 30% të tyre. Numri i kallëzimeve penale të hedhura poshtë/mbyllura apo hetimeve të ndërprera ka qenë më i lartë gjatë vitit 2014, me vetëm 26% të rasteve të akuzuara apo 28 persona, ndërsa kundër 84 personave janë mbyllur hetimet apo rastet janë hedhur poshtë/mbyllur. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, ka pasur një përmirësim të vogël me 37 prej 41 persona të akuzuar apo 90% të rasteve të akuzuar me kallëzime penale (Shih Tabelën 1.6). Prokurorët e Prokurorisë Speciale kanë hedhur poshtë/mbyllur kallëzime penale për 4 (katër) persona apo 10% të rasteve. Edhe pse ka një përmirësim në aktakuza, megjithatë numri mesatar i rasteve të trajtuara nga prokurorët është i ulët me aktakuza, duke përfshirë më pak se 5 (pesë) raste të korrupsionit të trajtuara nga prokurorët për gjysmën e parë të vitit 2015.

Koordinatori Kombëtar kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit i ka dërguar një propozim Këshillit Prokurorial të Kosovës për emërimin e një komisioni për të analizuar modelin dhe shkaqet e hedhjes poshtë/mbylljes të kallëzimeve penale dhe ndërprerjen e hetimeve nga ana e prokurorëve. Komisioni, në mes të tjerash, do të analizonte nëse hedhja poshtë vije si rezultat i parashtrimin të

⁵⁷ Raporti vjetor i mekanizmit përcjellës ndër-institucional për harmonizimin e statistikave për veprat penale karakteristike për vitin 2013, si dhe komunikim i KIPRED me Këshillin Prokurorial të Kosovës përmes emailit.

dobët të kallëzimeve penale nga ana e policisë apo institucioneve të tjera, apo nëse ky fenomen është i ndikuar nga trajtimi i dobët i rasteve nga ana e prokurorëve.⁵⁸ Në tetor të vitit 2015, prokurori i shtetit të Kosovës i sapoemëruar ka nxjerrë një vendim me anë të së cilit lejohet krijimi i komisionit, në përbërje prej katër prokurorëve, për të bërë vlerësimin e lëndëve për çështje që lidhen me korrupsionin në zyrat e prokurorisë, përfshirë rastet që janë hedhur poshtë/mbyllur apo ndërprerë.⁵⁹ Me qëllim të rritjes së llogaridhënies ndaj prokurorëve, mbetet të vlerësohet efikasiteti dhe ndërhyrja potenciale e prokurorisë së shtetit në instancat e tjera të prokurorisë.

d) Gjykimi i rasteve të korrupsionit nga gjykatat:

Ngjashëm me shërbimet prokuroriale, edhe gjykatat kanë pasur pengesa në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Për shembull, gjatë vitit 2014 gjykatat kanë punuar me 655 raste të korrupsionit, megjithatë kanë arritur që të gjykojnë vetëm 35% të tyre apo 229 lëndë. Shumica e 426 apo 65% të rasteve kanë mbetur të pazgjidhura. Prej rasteve të zgjidhura nga ana e gjykatave kanë qenë 120 aktgjykime me anë të së cilave 132 persona janë shpallur fajtorë. Prej këtij totali kanë qenë 35 persona të dënuar me burgim ndërsa të tjerët janë dënuar me gjoba apo dënime të tjera. Ndryshe, gjykatat kanë nxjerrë 41 aktvendime për pafajësi për 58 persona (Shih Tabelat 1.7 dhe 1.8).

Në gjysmën e parë të vitit 2015, gjykatat kanë punuar në 490 raste të korrupsionit, megjithatë kanë arritur që të gjykojnë vetëm 17% të tyre apo 84 lëndë. Prej numrit të përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura, janë shpallur 46 aktgjykime të fajësisë kundër 65 personave. Dënimet me burgim janë dhënë për 14 raste kundër 24 personave, ndërsa në anën tjetër ka pasur 12 aktvendime për pafajësi për 17 persona (Shih Tabelat 1.7 dhe 1.8).

Për më tepër, raportimi i të dhënave për aktvendimet e gjykatave në lidhje me rastet e korrupsionit kanë vazhduar të jenë të paqarta. Për shkak të mungesës së një sistemi të mirëfilltë të menaxhimit të lëndëve që lidh zbatimin e ligjit, prokurorinë dhe gjykatat në një bazë të dhënash qendrore, statistikave të lëndëve vazhdojnë të raportohen ndryshe nga institucione të ndryshme. Këshilli Prokurorial ka të zhvilluar bazën e vetë të të dhënave, e cila është e njohur si “Mekanizmit Përcjellës Ndër-institucional për Harmonizimin e Statistikave të veprave karakteristike penale”. Të dhënat që publikohen në mekanizmin përcjellës nga ana e KPK-së janë publike. Megjithatë, statistikave të cilat futen nga vendimet gjyqësore në Mekanizmin Përcjellës të KPK-së nuk përputhen me statistikave që futen në bazën e të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të dhënat që futen në Mekanizmin Përcjellës të KPK-së janë shumë më të ulëta se ato që futen nga KGJK-ja. Mospërputhja paraqitet ku rastet e raportuara nga KPK-ja nuk janë raportuar domosdoshmërisht në të njëjtin vit edhe nga

⁵⁸ Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raporti për implementimin e planit të veprimit për rritjen e efikasitetit në sistemin prokuroria në luftën kundër korrupsionit, 16 tetor 2014, f. 7. Në këtë vegëz: http://www.psh-ks.net/repository/docs/284_Raport_mbi_zbatimimin_e_planit_te_veprimit.pdf

⁵⁹ Deklarata e zyrtarit të lartë të Prokurorisë së Shtetit, në Tryezën e Rrumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe SiV, Tetor 2015, në Prishtinë.

KGJK-në, në anën tjetër gjykatat shpeshherë e vonojnë raportimin në kohë të rasteve.⁶⁰ Sipas të dhënave të KPK-së gjatë vitit 2014 gjykatat kanë vendosur kundër 103 personave, ndërsa KGJK raporton se është vendosur për raste kundër 307 personave. Për shembull, ndërsa KPK-ja raporton për 67 persona të shpallur fajtor për akuzat për korrupsion dhe për 18 të liruar, KGJK-ja ka raportuar për 132 persona të shpallur fajtorë dhe 58 persona të liruar. Kjo është një mospërputhje e madhe në statistikat e regjistruara.⁶¹

Në një përpjekje për të zgjidhur çështjen e menaxhimit të lëndëve, Qeveria e Norvegjisë ka sponsorizuar Projektin mbi teknologjinë informative ICT/CMIS që nga vitit 2013, duke nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me KGJK-në, KPK-në, Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe Ambasadën e Norvegjisë. Megjithatë, projekti është ballafaquar me vështirësi që nga fillimi i saj kryesisht për shkak të mungesës së aftësisë dhe kapacitetit profesional nga ana e personelit gjyqësor dhe administrativ për të trajtuar reformën e teknologjisë informative e kërkuar nga projekti.

Mospërputhja në raportimin e të dhënave nga ana e institucioneve të përfshira duhet të zgjidhet urgjentisht pasi që një gjë e tillë ka pasur një ndikim dhe pasoja të rënda në punën e gjyqësorit, të cilit i mungon raportimi i qartë i të dhënave dhe vazhdon të minojë besueshmërinë e institucioneve të sundimit të ligjit.

V. Vonesat e qëllimshme në trajtimin e korrupsionit ndaj profilit të lartë: Parashkrimi i Rasteve të Korrupsionit

Një taktikë tjetër për të vonuar nxjerrjen e aktvendimeve në lëndët që lidhen me korrupsionin, janë gjithashtu edhe afatet kohore për të hetuar dhe parashtruar aktakuzat, në veçanti në rastet të cilat ndërlihen me zyrtarët e profilit të lartë. Në të paktën dy raste që lidhen me korrupsionin e profilit të lartë, të ashtuquajturat lënda Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe lënda e Aferës së Armëve të Policisë së Kosovës që ndërlihen me abuzimin e autoritetit dhe autorizimeve zyrtare, përfundimi i afatit kohor prej dy vjetësh për kryerjen e hetimeve, janë shfrytëzuar si shkaqe për të hedhur poshtë rastet pasi që nuk janë parashtruar aktakuzat nga ana e prokurorëve brenda këtij afati të përcaktuar kohor. Lënda e KEK-ut përfshinë aktakuzat e ngritura nga prokurori i EULEX-it të datës 16 Janar 2015, kundër zyrtarëve të nivelit të lartë, duke përfshirë kryetarin e Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, drejtorin e KEK-ut, Arben Gjukaj, Kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha, Shefi i Prokurimit të KEK-ut Hasan Pruthi dhe kushëririn e afërt me Kryetarit të Komunës Sami Lushtakun, Milazim Lushtaku, i cili është pronar i kompanisë së sigurimeve, të cilës iu ishte

⁶⁰ Intervistë e KIPRED me zyrtarin e lartë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 25 gusht 2015 në Prishtinë.

⁶¹ Deklaratë e gjyqtarit të Gjykatës Themelore të Gjakovës, dhënë në Tryezën e Rrumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe SiV, 7 Tetor 2015, në Prishtinë.

dhënë një tender nga KEK-u, duke dëmtuar përafërsisht KEK-un në vlerë prej 6,182,609.76 euro.⁶² Aktakuza ka qenë e ngritur kundër 7 (shtatë) të pandehurve, të cilët janë akuzuar për kryerje të veprës penale të mashtrimit dhe falsifikimit të dokumentacionit, për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, nxitje për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, dhe lidhje të kontratës së dëmshme. Në gusht të vitit 2015, Gjykata e Apelit miratoi kërkesën e avokatëve të palës së pandehur për të hedhur poshtë çështjen për shkak të parashkrimi të afatit kohor për hetim, i cili kishte përfunduar në tetor 2014, ndërsa aktakuza e prokurorit ishte parashtruar tek në janar të vitit 2015.⁶³

Një tjetër rast i korrupsionit të profilit të lartë, e mbyllur për arsye të ngjashme që lidhen me procesin e tenderimit për furnizim me armë, municion dhe pajisje të mbikëqyrjes për Policinë e Kosovës (PK) dhe të ashtuquajturin rasti APEX, i dyshuar për krimin e e shpërlarjes së parave. Aktakuza është ngritur edhe nga prokurori i EULEX-it i PSRK, më 19 janar 2015 kundër tre zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe dy biznesmenëve, për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë edhe ato të krimit të organizuar, furnizim të paautorizuar, transportit ose shitjes së armëve, mashtrimit dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Megjithatë, aktakuza ishte rrezuar në muajin maj të vitit 2015 duke u thirrur në arsyet e sipërpërmendura.⁶⁴

Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, afati kohor i përcaktuar për periudhën e kryerjes së hetimeve është 2 (dy) vite dhe procedurat penale duhet të përfundojnë nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë nga ana e prokurorit brenda afatit të arsyeshëm kohor, pas përfundimit të afatit kohor për kryerjen e hetimeve.⁶⁵ Afati kohor mund të vazhdohet për një periudhë shtesë prej gjashtë (6) muajsh, vetëm në rastet siç janë përkufizuar në këtë Kod.⁶⁶ Afati kohor për kryerje të hetimit dhe aktakuza duket se nuk interpretohen në të njëjtën mënyrë nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme. Sipas qarkores të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme afati kohor i caktuar automatikisht e përfundon edhe procedurën penale, duke e bërë aktakuzën të pamundur pas përfundimit të afateve të përcaktuara me ligj.⁶⁷ Shumica e prokurorëve të shtetit deri më tani kanë pretenduar se ata kanë përdorur interpretimin e gjykatës supreme pasi që prokurorët nuk mund të ngrenë aktakuza pas përfundimit

⁶² Prokurori i EULEX-it ka ngritur aktakuza kundër pronarëve të kompanisë "Security Code", që përfshin kushëririn e afërt të kryetarit të komunës Sami Lushtakut, Milazim Lustaku, Esat Tahiri dhe një partner tjetër Agron Jusufi. Shiko Komunikatën për Shtyp të EULEX-it, "Aktakuza e ngritur në rastin për korrupsion ndaj KEK-it", 16 janar 2015. Në, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0653.php>

⁶³ Gjykata e Apelit ka arsyetuar në aktvendimin e saj duke përdorur nenin 159 të Kodit të Procedurës Penale, Paragrafi 1, i cili përkufizon Afatet Kohore të Hetimeve. Prandaj, "Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet."

⁶⁴ Shiko Komunikatën për Shtyp të EULEX-it, në <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2.10.2>. Shiko gjithashtu "S"ka të dënuar për aferën e armëve", 5 qershor 2015. Në, <http://klankosova.tv/ska-te-denuar-per-afere-e-armeve/>.

⁶⁵ Shiko Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rastin e KEK-ut, nëntor 2015. I disponueshëm në KIPRED. Shiko gjithashtu Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 159, Paragrafi 1, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

⁶⁶ Neni 159, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁷ Qarkorja e Kryetarit të Gjykatës Supreme për Kryeprokuroren e Shtetit, lëshuar me 19 janar 2015. Qarkorja është e disponueshme në KIPRED.

ligjor të fazës së hetimeve dhe janë këshilluar që të mos vepronë në këtë mënyrë, pasi që është përcaktuar në qarkore se pas përfundimit të afatit ligjor për kryerjen e hetimeve, lëndët nuk duhet të sillen në gjykata, pasi që ato do të refuzohen në mënyrë automatike.⁶⁸ Në mënyrë të ngjashme aktakuza në lidhje me një vepër penale dhe parashkrimi i padisë është përdorur në rastin e njohur si "rasti APEX"⁶⁹, në lidhje me krimin e organizuar të lojërave të fatit dhe të industrisë së kazinove në Kosovë. Aktakuza është ngritur në prill të vitit 2015 nga një prokuror i EULEX-it kundër njëmbëdhjetë (11) pandehurve.

Ndryshe, në një rast të ngritur nga prokurori i EULEX-it i PSRK-së të Gjykatës Supreme të Kolegjit në të ashtuquajturin rasti i KEK-ut, kolegji ka gjetur se aktakuza mund të paraqitet pas përfundimit të afatit të propozuar për hetim, megjithatë brenda një afati kohor të arsyeshëm.⁷⁰ Për më tepër, kolegji nuk pajtohet me opinionin e nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Supreme dhe si të tillë nuk e konsideron atë ligjërisht të detyrueshëm.⁷¹

Kjo praktikë është ndjekur vetëm në ankesën e prokurorit të PSRK dhe gjykimin nga ana e kolegjit të Gjykatës Supreme, duke vendosur në konstatimin e aktakuzës në rastin e KEK-ut si të vlefshme dhe kthimin e lëndës në shkallë të parë për rigjykim. Në rastin tjetër që ndërlidhet me APEX dhe Policinë së Kosovës aktakuza ndaj aferës së armëve ishte parashkruar për shkak të afateve kohore të përcaktuara nga Qarkorja e Gjykatës Supreme. Këto paqartësi ligjore duhet të zgjidhen shumë shpejt nga Gjykata Supreme, duke nxjerrë një qarkore e cila do të sqaronte dhe përkufizonte në hollësi formulimet ligjore në lidhje me parashkrimin e veprave penale që kanë të bëjnë sidomos me rastet komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë. Siç është theksuar në Raportin e Progresit të BE-së të vitit 2015⁷², afatet kohore për të vendosur në lidhje me hetimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit janë të shkurtra, gjë që ka rezultuar që gjykatat të mos kanë informacion të mjaftueshëm për të nxjerrë një vendim të informuar.

Dështimi për të ngritur një aktakuzë brenda afatit të paraparë kohor ka siguruar një hapësirë për prokurorët e shtetit të Kosovës që të mos merren me raste të ndërlikuara, duke mbështetur pandëshkueshmërinë e disa rasteve të profilit të lartë. Për më tepër, Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit ka raportuar gjithashtu se kjo taktikë është përdorur nga prokurorët me rastet e paraqitura për hetim nga Agjencia të cilat janë lënë pa mbikëqyrje dhe janë parashkruar pasi që aktakuzat nuk janë paraqitur në brenda kohës së duhur.⁷³ Megjithatë, prokurorët janë duke vepruar brenda afateve të caktuara në Qarkoren e Gjykatës Supreme, duke shfrytëzuar mundësinë e parashkrimit të lëndëve, në rastet kur nuk është ngritur ndonjë aktakuzë brenda afateve kohore të

⁶⁸ Intervistë e KIPRED me zyrtarin e lartë të PSRK dhe zyrtarin e lartë të KGJK, gusht-shtator 2015.

⁶⁹ Shiko Deklaratën e Zyrtarit të Prokurorisë Speciale, në: <http://www.psh-ks.net/?page=2,8,719>

⁷⁰ Shiko Aktvendimin e Gjykatës Supreme në mbrojtjen e ligjshmërisë nga ana e prokurorëve të PSRK në rastin e KEK-ut, lëshuar në nëntor 2015. I disponueshëm në KIPRED.

⁷¹ Po aty.

⁷² Raporti i Progresit i Kosovës 2015, f. 15.

⁷³ Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, janar – dhjetor 2013 dhe 2015, f. 14, 15. Në, <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti-01-Janar-31-Dhjetor-2013-verzioni-shqip.pdf> dhe <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti%20vjetor%20final%202014%20-%20versioni%20shqip%20%281%29.pdf>

përcaktuara për kryerjen e hetimeve.⁷⁴ Disa prej rasteve të parashkruara janë karakterizuar si të qëllimshme.⁷⁵

Afati i tanishëm për kryerjen e hetimeve të rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë duket disi i shkurtër, duke marrë parasysh kompleksitetin e lëndëve.⁷⁶ Prandaj, duhet të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativ për të siguruar që afatet kohore për kryerjen e hetimeve nuk pengojnë luftën efektive kundër korrupsionit. Kryeprokuroret duhet të sigurojnë gjithashtu raportim të rregullt të prokurorëve të shtetit në lidhje me statusin e hetimeve të rasteve në mënyrë që të përjashtohet çdo neglizhencë e qëllimshme e në veçanti në rastet që ndërlidhen me korrupsionin ndaj profilit të lartë.

VI. Hetimi dhe konfiskimi i pasurisë në rastet e korrupsionit të profilit të lartë

Një regjistrim i ndjekjeve dhe dënimeve të suksesshme të rasteve, në veçanti të atyre të profilit të lartë, ka qenë një kusht i përcaktuar nga BE-ja i cili është përsëritur ndër vite nga e kaluara.⁷⁷ Në mënyrë që të përmirësohet lufta e përgjithshme kundër korrupsionit, BE-ja ka kërkuar gjithashtu caktimin e lëndëve kundër korrupsionit të profilit të lartë në bazë të prioriteteve, posaçërisht të lëndëve që ndërlidhen me sektorin e prokurimit publik, duke vendosur me dënime të formës së prerë. Hetimet kundër korrupsionit të profilit të lartë janë rritur, edhe pse të rralla e deri më tani nuk kanë rezultuar fare në nxjerrjen e dënimeve të formës së prerë.⁷⁸

Gjatë vitit 2015, disa politikanë janë dënuar për korrupsion, duke pasur disa raste në proces e sipër, pasi janë kthyer në rigjykim. Për shembull, kryetari i Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, fillimisht i dënuar për akuzat për korrupsion me 2 (dy) vite burgim me kusht nga Gjykata Themelore në Prizren, pas apelimit ishte kthyer në rigjykim. Ndërkohë, prokurori i çështjes së apeluar pranë Gjykatës Supreme, përsëri kishte kthyer lëndën në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim.⁷⁹ Rasti është në proces e sipër.

Ish Ministri i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj është akuzuar edhe me korrupsion të dyshuar në të ashtuquajturat rastet MTPT 1 dhe MTPT 2. Aktakuzat u bashkuan në

⁷⁴ Intervistë e KIPRED me prokurorin e shtetit, shtator 2015, Prishtinë.

⁷⁵ Intervistë e KIPRED me zyrtarin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe prokurorin e special pranë PSRK gusht dhe shtator 2015 në Prishtinë.

⁷⁶ Shiko gjithashtu Këshilli i Evropës, Projekti Kundër Krimeve Ekonomike (PKKE), Vlerësimi i raportit në lidhje me pëmbushjen e standardeve ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit (KK), prill 2015, f. 186.

⁷⁷ Raporti i tretë i Progresit për Kosovën në pëmbushjen e kushteve të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave (dhjetor 2015) në: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/international-affairs/general/docs/third_report_progress_kosovo_fulfilling_requirements_visa_liberalisation_roadmap_en.pdf.

⁷⁸ Po aty, f. 16.

⁷⁹ Telegrafi, "Supremja Kthen në Apel Vendimin për Ramadan Mujën (at <http://www.telegrafi.com/supremja-kthen-ne-apel-vendimin-per-ramadan-mujen/>)

vitin 2015 në një aktakuzë të vetme dhe rasti është në proces e sipër.⁸⁰ Përveç kësaj, një ish-politikan i PDK-së është nën gjykim, siç është rasti i Kryetarit të Komunës së Skenderajt, në rastin e ashtuquajtur të KEK-ut, i cili fillimisht ishte parashkuar, por më vonë ishte kthyer nga Gjykata Supreme në rigjykim.⁸¹ Për më tepër, dy ish ministra nga radhët e LDK-së z. Astrit Haraqija dhe z. Valton Beqiri janë akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe nënshkrimin e kontratave në vlerë prej 570.000 Eurove, duke shkelur ligjin e prokurimit publik. Ata janë dënuar vetëm me kusht për 10 muaj, dhe për momentin është duke u zhvilluar procedura e ankesës kundër aktvendimit.⁸² Një tjetër lëndë në proces e sipër është lëndë kundër një deputeti tjetër të LDK-së z. Naser Osmani, i akuzuar për korrupsion në dhjetor të vitit 2015.⁸³ Në shumicën e rasteve, ish-politikanët, të cilët nuk janë të lidhur fort me strukturat e partive politike në pushtet janë hetuar me disa përjashtime.

Kohëve të fundit, në një një periudhe prej dy muajsh të gjysmës së dytë të vitit 2015, disa prokurorë dhe gjyqtarë, kryesisht të profilin të lartë, kanë qenë objekt i arrestimeve dhe aktakuzave nga homologët e tyre për vepra të mundshme të rënda penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndër pjesëtarët e profilin të lartë të akuzuar kanë qenë Kryetari i Gjykatës së Apelit, Z. Sali Mekaj i akuzuar nga prokurori vendor i PSRK për veprën penale të dyshuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar.⁸⁴ Gjithashtu ndaj ish Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese z. Enver Hasani është ngritur aktakuzë për veprën penale të dyshuar për mashtrim në detyrë.⁸⁵ Ngjarjet e fundit janë vlerësuar nga disa zyrtarë gjyqësorë, të cilët i kanë konsideruar këto veprime si të nevojshme për të "pastruar dollapin", përpara se këto institucione të jenë në gjendje të luftojnë krimin në sektorë të tjerë.⁸⁶ Të tjerë kanë pretenduar se kjo mund të jetë një mënyrë për të larguar ata prokurorë që nuk janë besnik dhe as të bindur ndaj Kryeprokurorit të sapoemëruar të Shtetit.⁸⁷

Për më tepër, në lidhje me hetimet për pasurinë e pashpjegueshme, KIPRED-i ka raportuar në të kaluarën se shumica e zyrtarëve të lartë me rastin e emërimit në pozita vendimmarrëse kanë fituar pasuri të pashpjegueshme, e cila nuk përputhet me të ardhurat e tyre të përgjithshme.⁸⁸ Për më tepër, BE-ja në Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave për Kosovën, kishte përcaktuar nevojën për të filluar hetimet në lidhje me pasurinë e pashpjegueshme. Megjithatë, prokurorët e shtetit të Kosovës, janë ankuar për mungesë ligjore për të vepruar në raste të tilla, edhe përkundër faktit se deklarimi i

⁸⁰ Betimi për Drejtësi "Anulohen seancat për muajin shkurt në rastin MTP" <http://betimiperdrejttesi.com/vjollca-kelmendi-deshmon-sot-ne-rastin-limaj-te-mtpt-se/>

⁸¹ Aktvendimi i Gjykatës Supreme në KIPRED.

⁸² Shiko Koha net në <http://koha.net/?id=27&l=86897> Haraqija dhe Beqiri dënohen me nga 10 muaj me kusht (2015).

⁸³ Lajm i Prokurorisë së Shtetit: Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër tetë (8) të pandehurve: për veprat penale: "Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar", "Legalizimi i Përmbajtjes së Rreme", "Mashtrimi" dhe "Shmangie nga Tatimi" në: <http://www.psh-ks.net/?page=2,8,873>

⁸⁴ Prokuroria e Shtetit, Njoftim për Media, 21 korrik 2015. Në, <http://www.psh-ks.net/?page=2,8,775>

⁸⁵ Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve: Enver Hasani, Hakif Veliu dhe Albert Rakipi për veprën penale "Mashtrimi në Detyrë" 31 korrik 2015. At, <http://www.psh-ks.net/?page=2,8,780>

⁸⁶ Intervistë e KIPRED me zyrtarë të lartë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gusht 2015 në Prishtinë

⁸⁷ Burim i KIPRED nga një OJQ vendore mbi sundimin e ligjit, shtator 2015.

⁸⁸ Shih për shembull, raportin e KIPRED-it "Pandëshkueshmëria në Kosovë, Pasuria e Pashpjegueshme", nëntor 2013, në http://www.kipred.org/repository/docs/THE_IMPUNITY_IN_KOSOVO_INEXPLICABLE_WEALTH_632453.pdf.

pasurisë dhe pronave nga ana e zyrtarëve të lartë është publike.⁸⁹ Për të kryer verifikimit prokurorët mund të mbështeten në një dyshim të arsyeshëm se pasuria është fituar me vepër penale. Deri më tani zyrtarët e lartë verifikohen vetëm nga ACA, që ka kapacitet për të verifikuar vetëm 20% të zyrtarëve, duke qenë se rekomandimi i BE-së është që agjencia të mos zgjedh vetëm zyrtarët për verifikim, por gjithashtu të zgjedh edhe pozitat e caktuara të cilat mund të kenë më tepër prirje për korrupsion.⁹⁰ Për më tepër, Koordinatori Kombëtar për Krime Ekonomike ka rekomanduar edhe krijimin e një njësie të policisë që do të ndihmonte zyrtarët e ACA-s për të kryer verifikimin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publik.⁹¹ Rrjedhimisht, nëse do të kishte rritje të pasurisë së raportuar, një ekip i bashkuar nga ACA-Policia-Prokuroria do të duhej të themelohej në mënyrë që të kryhej verifikimi i rasteve të tilla.⁹²

Megjithatë, pa një ndryshim të barrës së provës nga prokurorët e shtetit tek të dyshuarit për të provuar origjinën e pasurisë së tyre, duket se ka një mungesë e përgjithshme të vullnetit nga ana e prokurorëve për të hetuar krijimin e pasurisë së pashpjegueshme në Kosovë, e cila fitohet nga zyrtarë të profilin të lartë, duke vazhduar mosndëshkimin, si rezultat i mos hetimit dhe ndjekjes penale. Me hyrjen në fuqi të kodit të ri penal në vitin 2013, deklarimi i rrejtshëm i pasurisë, konsiderohet vepër penale. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë hetim të duhur nga ana e prokurorëve të shtetit mbi burimin e pasurisë së fituar nga zyrtarët e lartë. Prandaj, gjatë vitit 2015 zyrtarët e lartë kanë vazhduar të ofrojnë më pak informacion në lidhje me burimin e pasurisë së fituar. Për shembull në bazë të një përzgjedhjeje të një mostre⁹³ disa deputetë nuk kanë ofruar informacion të mjaftueshëm në lidhje me pasurinë e deklaruar, duke deklaruar vetëm pasurinë e patundshme të trashëguar dhe duke mos ofruar informacionin e plotë në lidhje me vitin kur ajo pasuri është përfituar dhe gjithashtu duke mos e deklaruar as vlerën e pronës së patundshme, duke e lënë një hapësirë të tillë të shënuar me vlerë të barabartë me zero.⁹⁴

Numri i rasteve të aktakuzat të ngritura në lidhje me konfiskimin e përgjithshëm të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme vazhdon të jetë shumë i ulët nga gjykatat. Gjatë vitit 2015 Koordinatori

⁸⁹ Intervistë e KIPRED me prokurorë të shtetit, Shtator 2015, Prishtina.

⁹⁰ F. 17 i Raportit të Progresit për Kosovën i BE-së për vitin 2015, i disponueshëm në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

⁹¹ Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raporti mbi Aktivitetet dhe Rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, prill-qershor 2014, f. 3. At, http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.856.2014_RAPORT_TREMUJOR_PRILL_QERSHOR_I_KOORDINATORIT_KPK.PDF

⁹² Po aty.

⁹³ KIPRED ka analizuar gjithsej 47 deputetë me 17 deputetë nga partia më e madhe, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), 16 deputetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), 6 deputetë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe 8 deputetë nga partia Vetëvendosje (VV). Për më tepër janë analizuar edhe deklaratimet e pasurisë nga kabineti qeveritar.

⁹⁴ Shiko deklarinimin e pasurisë së deputetit të PDK-së Besim Beqaj në http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Besim_Beqaj.pdf, deputetes Blerta Deliu-Kodra në, http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Blerta_Deliu-Kodra.pdf dhe/apo deputetes Safete Hadergjonaj, në, http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Safete_Hadergjonaj.pdf

Kombëtar kundër Krimeve Ekonomike ka raportuar një shumë prej 70,489.00 euro.⁹⁵ Gjatë vitit 2014 pasuria e konfiskuar pas aktgjykimeve përfundimtare të gjykatës kanë përlogaritur një shumë prej 1 milion euro të konfiskuar, megjithatë, nga një konfiskim i vjetër i regjistruar vetëm më së voni në vitin 2014.⁹⁶ Në vitin 2013, shuma e sekuestruar është përafërsisht rreth 1,555,258.43 euro, ndërsa shuma e konfiskuar 6,700.00 mijë euro.⁹⁷ Në përgjithësi, ka pasur një rritje të qëndrueshme të konfiskimit, megjithatë shumat minimale janë konfiskuar dhe transferuar në Buxhetin e Kosovës përgjatë viteve.

Në fund, shumica e rasteve të hetuara kohët e fundit dhe të akuzuara, janë të ngritura kundër ish politikanëve apo figurave me fuqi më të dobët politike. Adresimi i rasteve të profilit të lartë të lidhura drejtpërdrejtë me strukturat e pushtetit të partive kryesore në koalicionin PDK dhe LDK nuk del se është ndonjë praktikë e zakonshme. Koalicioni aktual vazhdon të veprojë brenda “martesës me marrëveshje”, marrëdhënie që në një mënyrë garanton pandëshkueshmërinë nga hetimet dhe ndjekja penale e elitës aktuale politike në pushtet.

⁹⁵ Komunikim me e-mail në mes të KIPRED-it dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, Janar-Shkurt 2016.

⁹⁶ Burim zyrtar i KIPRED-it – projekt i drejtuar dhe financuar nga BE

⁹⁷ Komunikim me e-mail në mes të KIPRED dhe KKKE, 2014-2015.

VII. Përfundim dhe Rekomandime

Ka pasur një reagim të shpejtë nga ana e prokurorëve të shtetit dhe gjykatave në drejtim të hetimit dhe ngritjes së aktakuzave kundër rasteve individuale për prishje të rendit dhe qetësisë publike të shkaktuar nga protestat e opozitës. Në anën tjetër drejtësia është shumë më e ngadalshme kur është fjala për t'i dhënë fund mosndëshkimit të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë të koalicionit në pushtet. Edhe pse kanë kaluar më shumë se tetë vite prej kur Kosova ka shpallur pavarësinë e saj, BE-ja vazhdon ta vlerësojë sistemin e saj të drejtësisë se është në fazën fillestare të mirë-funksionimit. (Raporti i Progresit i KE 2015).

Kosova do të vazhdon të vuajë dhe të jetë shtet jofunksional si pasojë e korrupsionit në veçanti nga korrupsioni i profilit të lartë dhe pandëshkueshmërisë së tij derisa mungon realisht vullneti politik për të e luftuar atë në mënyrë efektive. Në këtë drejtim edhe rritja e llogaridhënies dhe përgjegjësisë nga ana e gjyqësorit është më se e nevojshme. Përkundër amandamentimeve dhe nxjerrjes së ligjeve të reja, moszbatimi i tyre i plotë ka lënë luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë në stadin fillestar. Në veçanti konfiskimet e pasurisë së jashtëligjshme të krijuara nga korrupsioni i profilit të lartë janë pothuajse joekzistente.

Shënimet ekzistuese për përndjekjen, aktakuzat dhe vendimet gjyqësore lidhur me rastet e korrupsionit të profilit të lartë tregojnë një trend në rritje. Mirëpo këto raste janë të vonshme dhe ende priten të shihen rezultatet e dukshme duke filluar nga krijimi i një data-baze të shënimeve lidhur me dënimet finale pra me aktgjykim të ekzekutueshëm si dhe me konfiskimin e pasurisë së krijuar në mënyrë të jashtëligjshme. Parashkrimi i veprave penale që lidhen me rastet e korrupsionit të profilit të lartë, duket si taktikë për të lënë rastet e komplikuar nga vëmendja e sistemit të drejtësisë dhe duke dhënë mesazhe jo të mira për sundimin e ligjit në përgjithësi si dhe vazhdimin e pandëshkueshmërisë së këtyre rasteve.

Në mënyrë që të përmirësohet lufta kundër korrupsionit, si dhe ajo e profilit të lartë në veçanti, KIPRED propozon rekomandimet e mëposhtme:

- Autoritetet vendimmarrëse duhet të tregojnë vullnet të qartë politik për të luftuar korrupsionin të profilit të lartë, në mënyrë të veçantë me ndarjen e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe buxhetore. Në veçanti, një rishikim gjithëpërfshirës dhe strategjik i reagimit të sistemit gjyqësor në rastet e korrupsionit është i nevojshëm, ashtu që të ikim nga reagimet *ad hoc*, shpesh të dominuara nga proceset politike. Në mënyrë që të sigurojmë një reagim më të fokusuar dhe strategjik, rishikimi duhet të marrë në konsideratë punën e palëve të interesuara, duke përfshirë të shoqërisë civile;
- Rishikimi strategjik duhet të sigurojë gjithashtu edhe krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe autonom për të ofruar rezultate me shpejtësi dhe përmes një qasje jo-selektive. Për më tepër, sistemi gjyqësor duhet të veprojë dhe t'i rezistojë ndonjë ndërhyrjeje të mundshme duke zhvilluar një strategji të qartë komunikimi me palët e interesuara, duke përfshirë trajtimin e ekspozimit të mundshëm në media të fazave fillestare të hetimeve;
- Autoritetet e drejtësisë duhet të veprojnë në suazat e legjislacionit të tanishëm për luftimin e korrupsionit përfshirë këtu edhe korrupsionin e profilit të lartë. Kosova mund të marrë në

konsideratë konfiskimin e pasurisë të sojit të njëjtë (*in rem*) të përfituar me vepër penale, me një barasvlerë të probabilitetit bazuar në standardet e të drejtës civile dhe jo në standardet e të drejtës penale përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Masa të tilla të përkohshme duhet të krijojnë një bazë të mjaftueshme ligjore për të hetuar pasurinë e pashpjegueshme.

- Prokurorët special do të duhet të rrisin transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut me rastin e përndjekjes penale të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë duke komunikuar rregullisht me publikun. Për më tepër prokurorët special do të duhej të largohen nga 'komfort zona' e tanishme duke demonstruar iniciativë vetanake dhe konkrete në hetimin dhe ngritjen e aktakuzave për rastet e profilit të lartë.
- Agjencia Kundër Korrupsionit do të duhej ta rrisë edhe numrin e verifikimeve të pasurisë në përputhje me kërkesat e BE-së, për zyrtarët e profilit të lartë që janë më të ekspozuar ndaj korrupsionit sesa në rastet që i për zgjedhin në mënyrë të rastësishme. Bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë, Agjencionit Kundër Korrupsionit, Agjencisë Kosovare të Kadastrës si dhe Administratës Tatimore do të duhej të formalizohet në përputhje me rekomandimet e Koordinatorit Nacional kundër Krimin Ekonomik për rritjen e efektivitetit të këtyre organeve në luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë.
- Parashkrimi i hetimeve për rastet e korrupsionit të profilit të lartë duhet të ndërpritet si praktikë. Gjykata Supreme duhet të nxjerr mendim të menjëhershëm për sqarimin e çfarëdo lloj pasigurie juridike të krijuar me lëshimin e vendimit të panelit të kësaj gjykate për rastin individual si dhe qarkoren e lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

VIII. Shtojcë:

Tabela 1.1: Numri i kallëzimeve penale për rastet e korrupsionit, të raportuara në të gjitha Prokuroritë gjatë periudhës 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015						
Sipas parashtruesit	<i>Raporte</i>	<i>Persona</i>	<i>Raporte</i>	<i>Persona</i>	<i>Raporte</i>	<i>Persona</i>
	Viti 2013		Viti 2014		Gjysma e parë e vitit 2015	
Policia e Kosovës	236	634	198	449	98	197
Agjencia Kundër-Korrupsion	78	196	147	186	10	15
Dogana e Kosovës	1	9	2	2	2	6
E pranuar në kompetencë	0	0	22	57	11	34
Pala e dëmtuar	39	71	60	144	44	114
EULEX-i	4	16	1	1	0	0
Të tjera (qytetari,...)	18	45	24	89	16	23
Prokurori me vetiniciativë	4	6	11	17	0	0
Gjithsej në të gjitha Prokuroritë	436	1046	503	1011	186	400

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.2: Numri i kallëzimeve penale për rastet e korrupsionit, të raportuara në PSRK gjatë periudhës 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015						
Sipas parashtruesit	<i>Raporte</i>	<i>Persona</i>	<i>Raporte</i>	<i>Persona</i>	<i>Raporte</i>	<i>Persona</i>
	Viti 2013		Viti 2014		Gjysma e parë e vitit 2015	
Policia e Kosovës	0	0	10	63	2	7
Agjencia Kundër-Korrupsion	1	6	4	14	0	0
Dogana e Kosovës	1	9	0	0	0	0
E pranuar në kompetencë	0	0	8	41	4	12
Pala e dëmtuar	1	2	0	0	0	0
EULEX-i	2	7	0	0	0	0
Të tjera (qytetari,...)	1	11	9	38	1	2
Prokurori me vetiniciativë	0	0	0	0	0	0
Gjithsej në PSRK	6	35	31	156	7	21

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.3: Rastet e korrupsionit të trajtuara nga Prokuroritë gjatë periudhës 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015								
Të gjitha Prokuroritë	Numri i rasteve në punë	Numri i personave	Numri i rasteve të zgjidhura	% e rasteve të zgjidhura	Numri i personave, të cilëve u janë zgjidhur rastet	Numri i rasteve të pazgjidhura	% e rasteve të pazgjidhura	Numri i personave, të cilëve nuk u janë zgjidhur rastet
Viti 2013	778	2161	314	40%	665	464	60%	1496
Viti 2014	976	2569	444	45%	1011	532	55%	1558
Gjysma e parë e vitit 2015	717	2007	128	18%	301	589	82%	1706

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.4: Rastet e korrupsionit të trajtuara nga PSRK gjatë periudhës 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015								
PSRK	Numri i rasteve në punë	Numri i personave	Numri i rasteve të zgjidhura	% e rasteve të zgjidhura	Numri i personave, të cilëve u janë zgjidhur rastet	Numri i rasteve të pazgjidhura	% e rasteve të pazgjidhura	Numri i personave, të cilëve nuk u janë zgjidhur rastet
Viti 2013	47	297	17	36%	98	30	64%	199
Viti 2014	66	368	17	26%	107	49	74%	261
Gjysma e parë e vitit 2015	53	274	5	9%	41	48	91%	233

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.5: Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga të gjitha Prokuroritë gjatë periudhës 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015						
Të gjitha Prokuroritë	Numri i rasteve të zgjidhura	Numri i personave ndaj të cilëve janë ngritur kallëzime penale/ rastet e zgjidhura	Numri i personave ndaj të cilëve janë hedhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet	%	Numri i personave të akuzuar	%
Viti 2013	314	665	353	53%	312	47%
Viti 2014	444	1011	545	54%	471	47%
Gjysma e parë e vitit 2015	128	301	116	39%	185	61%

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.6: Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga PSRK gjatë periudhës 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015						
PSRK	Numri i rasteve të zgjidhura	Numri i personave ndaj të cilëve janë ngritur kallëzime penale/ rastet e zgjidhura	Numri i personave ndaj të cilëve janë hedhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet	%	Numri i personave të akuzuar	%
Viti 2013	17	98	69	70%	29	30%
Viti 2014	17	107	84	79%	28	26%
Gjysma e parë e vitit 2015	5	41	4	10%	37	90%

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.7: Vendimet e Gjykatës së shkallës së parë për rastet e Korrupsionit, sipas lëndëve, për periudhën 2014 dhe pjesën e parë të vitit 2015											
Viti	Gjithsej lëndë në punë	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Aktgjykime Fajësuese				Gjithsej Aktgjykime Fajësuese	Gjithsej Aktgjykime Liruese	Akgjykime Refuzuese	Lënda është zgjidhur në mënyrë tjetër
				Dënime me burgim	Dënime me gjobë	Dënime me kusht	Dënime tjera				
Viti 2014	655	229	426	38	37	43	2	120	41	20	48
		35%	65%	17%	16%	19%	1%	52%	18%	9%	21%
Gjysma e parë e vitit 2015	490	84	406	14	13	19	0	46	12	11	15
		17%	83%	17%	15%	23%	0%	55%	14%	13%	18%

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Tabela 1.8: Vendimet e shkallës së parë për rastet e Korrupsionit, sipas personave, për periudhën 2014 dhe pjesën e parë të vitit 2015											
Viti	Gjithsej persona te akuzuar	Gjithsej persona ndaj të cilëve ka përfunduar procedura gjyqësore	Numri i personave ndaj të cilëve nuk ka përfunduar procedura gjyqësore	Persona të shpallur Fajtor				Gjithsej Persona të shpallur Fajtor	Gjithsej Persona të Liruar	Persona me aktgjykim refuzues	Persona, lënda e të cilëve është zgjidhur në mënyrë tjetër
				Persona të dënuar me burgim	Persona të dënuar me gjobë	Persona të dënuar me kusht	Dënime tjera				
Viti 2014	1306	307	999	35	41	54	2	132	58	40	77
		24%	76%	11%	13%	18%	1%	43%	19%	13%	25%
Gjysma e parë e vitit 2015	1107	141	966	24	13	28	0	65	17	21	38
		13%	87%	17%	9%	20%	0%	46%	12%	15%	27%

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës